



SBASHK

Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kultures

Arsimimi

KULTURA E NJERIUT

Ë-buletin

Shkurt, 2016

**SBASHK-u u takua me kabinetin qeveritar të Kosovës
Gatishmëri e Qeverisë për zgjidhjen e kërkesave të
SBASHK-ut**



Në ambientet e Qeverisë së Kosovës kryetari i SBASHK-ut, Rahman Jasharaj, kryesia dhe anëtarët e Këshillit Drejtues janë takuar me Kryeministrin e Kosovës, Isa Mustafa, Zv/kryeministrat Hashim Thaçi e Kujtim Shala dhe me Ministrat Arban Abrashi e Arsim Bajrami. Ishte ky një takim në përbërje të gjerë e në kuadër të vazhdimet të dialogut me institucionet e Kosovës për shumë ... (faqe 5)

Edhe një takim me Ministrin Abrashi
**Formular unik për tërë Kosovën lidhur
me aplikimin për pensione**



Pasi ishte arritur marrëveshje me 14 janar që të implementohet në praktikë e drejta e mësimdhënësve ... (faqe 6)

SBASHK vazhdon angazhimet për forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar

SBASHK-u mysafir i sindikatës turke të arsimit “Egitim-Bir-Sen”
Me ftesën e sindikatës më të madhe të arsimit Egitim-Bir –Sen, që numëron 400.000....(faqe 8)

Intervistë me veteranin e arsimit dhe të sindikalizmit z. Bislim Behrami

Bislimi u gëzohet shumë arritjeve të vazhdueshme të SBASHK-ut

Bislimi ditëlindjen e ka në një datë të veçantë. Biografia e tij është e ngjashme me atë të moshatarëve. U shkollua e punoi në ... (faqe 3)

Marrëveshje të niveleve vendore e ndërkombëtare për zbritje çmimesh të shërbimeve
Në bregdetin turk, atë shqiptar dhe me bizneset vendore



Respekti për të punësuarit në arsimin Kosovës dhe për punën e angazhimet që po bën SBASHK-u në shërbim të tyre ... (faqe 6)



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës
The Union of Education, Science and Culture

Editorial

Shtatë Marsi- festa jonë



Pajtohem i të gjithë se ditët, vitet e besa edhe dekadat po ikin shpejt. Po na vjen kohë e pleqërisë e

me këtë edhe pensioni. Kjo fjalë sa po të përmendet sjell emocione dhe kujtesa nuk ndalet. Nis njeriu të mendojë për kohën e bukur të rinisë e për studimet. Shpalos albume fotografish dhe nis e bën krahasime për vetën, për mikun e për kolegët.

Edh e këtë vit SBASHK-u do ta festojë ditën e madhe të shkollës shqipe. Kolegët tanë e gëzofshin pensionin dhe Ju urojmë shëndet të mirë. Ata bashkërisht do të “ngacmojnë” kujtesën dhe do të shpalosin faqe të ndritura të historisë së shkollës shqipe. Do të nisin me Korçën e besa për një kohë të mirë do të ndalen në dekadën e fundit të shekullit të kaluar. Këta njerëz të organizuar në SBASHK u kthyen në mburojë të fuqishme të arsimit e kulturës

sonë dhe e mbrojtën me nder e krenari nga sulmet e pushtuesit. Kjo qëndresë i bën madhështor këta njerëz dhe e fënikëron edhe më shumë misionin e tyre prej pishtarëve të dijes. Kjo dekadë dhe puna e përkushtuar e mësuesit të Kosovës i shton madhësinë kësaj date të madhe. Shtatë Marsi është festa jonë dhe do ta kremtojmë me zemër duke shpalosur fragmente të shumta që janë dëshmi e përkushtimit të një lumi të madh njerëzish në emër të dijes, lirisë së atdheut dhe ardhmërisë së ndritur.

Ne po plakemi dhe kujtimet na emocionojnë, por jemi krenar se nuk i kemi mbetur borxh as kohës, as brezave e as Kosovës. Të tjerët dhe të shikojnë e le të pyeten a kanë bërë sa duhet e sa kanë mundur për këta njerëz të dijes.

Ditët, vitet e besa edhe dekadat po ikin shpejt, por 7 Marsi do të festohet gjithmonë në shenjë respekti për gjithë ata që me përkushtim kanë kryer misionin njerëzor për dije, dritë e kundër errësirës.

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë, mund të vizitoni ueb-faqen tonë:

www.sbashk-rks.org

Mos hezitoni të na jepni sugjerime për përfshirjen edhe të ndonji rubrike në interes të anëtarësisë në gazeten e juaj elektronike Arsimi sot.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbim të anëtarësisë, së shpejti do të ofroj shërbime këshillimi për ngritje profesionale për anëtarët e vet si dhe së shpejti do të paraqiten video-spote në ueb-faqen e SBASHK-ut rreth shërbimeve për anëtarësinë.

Botues: Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK)

përfaqëson rreth 20.500 anëtarë në gjithë sektorët e arsimit në Kosovë, duke përfshirë edhe komunitetet. SBASHK është anëtare e **Edukimit Internacional (EI)** që nga viti 1996.

Email: info@sbashk-rks.org

Tel. +381(0)38/ 226 940



Intervistë me veteranin e arsimit dhe të sindikalizmit z. Bislim Behrami

Bislimi u gëzohet shumë arritjeve të vazhdueshme të SBASHK-ut



Bislimi ditëlindjen e ka në një datë të veçantë. Biografia e tij është e ngjashme me atë të moshatarëve. U shkollua e punoi në kohë të vështira. Në SBASHK është që nga fillimi dhe gëzon respektin

e të gjithëve. Ai mburret me çdo arritje në arsim dhe në sindikatë. SBASHK-u po gëzon respekt nga të gjithë partnerët, por edhe nga opinioni dhe sindikatat simotra ndërkombëtare, e thotë me zërin plot krenari Bisi. Duke plotësuar dëshirën e shumë lexuesve tonë zhvilluam një intervistë me këtë veprimtar e mësues të dashur pikërisht për numrin festiv të gazetës sonë.

Arsimimi sot:

Kush është Bislim Behrami ?

Bislimi:

U lindi në fshatin Baks të Komunës së Skenderajt më 28 nëntor 1949. Shkollën fillore e nisa në Qirez për të vazhduar nga klasa e pestë në Galicë. Pas kësaj u regjistrova në Shkollën Normale, që kishte dy paralele në kuadër të Gjimnazit “Silvira Tomazini” në Mitrovicë për të vazhduar klasat tjera në Normalen e Mitrovicës. Në vitin 1969 i diktuar nga kushtet e vështira ekonomike nuk vazhdova studimet, por u punësova si mësues në shkollën e Qirezit. Isha mësuesi i dytë i diplomuar me Normalen atë kohë.. Pushteti i atëhershëm për arsye të qëndrimeve të mija më kishte në sy të keq dhe në vitin pasues nuk lejoj që të vazhdoj me punën. Në kushte tepër të vështira ekonomike shkova në Prishtinë dhe duke përjetuar skamje e mungesa të shumta materiale arrita ta përfundojë shkollën e parë të Fakultetit juridik dhe ta fitojë titullin e juristit. Por, pasi kishte mungesë kuadrosh për mësues, kolektivi i shkollës “Azem Bejta” në Prekaz me ftoi të punojë atje dhe pa lejen e Komitetit më pranoi në punë. Por strukturat e atëhershme politike më larguan nga puna pas një viti . Në vitin 1972 u bëra pjesë e kolektivit të shkollës “Migjeni” të Sibovcit e pas kësaj në vitin 1978 kalova

në shkollën “ Fazli Grajçevci” në Hade për të punuar këtu deri në pension.

Arsimimi sot:

Fillimet tuaja në aktivitetet e SBASHK-ut

Bislimi:

Në vitin 1990 pushtuesi nisi diskriminimin dhe sulmet ndaj arsimit shqip në Kosovë. Unë në atë kohë u zgjodha kryetar i shoqatës sindikale të shkollës dhe pas kësaj , si te ne, ashtu edhe në tërë Kosovën filluan angazhimet për unitet dhe ishte nevojë e kohës formimi i sindikatës në nivel vendi. Kështu u nisen themelet e SBASHK-ut dhe unë përfaqësoja mësimdhënësit e Kastriotit (Obiliqit). Në atë kohë kishte veprimtarë të devotshëm nga e tërë Kosova dhe punohej me plot sakrificë. U formuan edhe organet e SBASHK-ut dhe u zgjodh kryetari i parë, z. Agim Hyseni. Kishte atë kohë momente të vështira e duhej shumë angazhim e sakrificë, por kishte edhe plot momente krenarie. Në vitin 1993 me angazhimin e miqve të mëdhenj të SBASHK-ut e në radhë të parë sekretarit për përgjithshëm , z. Fred van Liven, kryetari i SBASHK-ut, dr. Agim Hyseni foli në Asamblenë e UNESCO-s duke prezantuar para gjithë botës gjendjen shumë të rëndë në arsimin e Kosovës. Moment i veçantë ishte edhe pranimi me të drejta të barabarta i SBASHK-t në Internacionalen Botërore të Arsimit.

Arsimimi sot:

Cilat janë momentet më të veçanta nga ato kohë?

Bislimi:

Janë shumë momente të veçanta ng ajo kohë. Më kujtohen momentet kur SBASHK-u organizonte protesta kundër politikës diskriminuese të pushtesit . Më kujtohen edhe momentet kur pushtuesi filloi të dëbonte nga shkollat fëmijët shqiptarë dhe SBASHK-u krijoi një mobilizim shembullor të mësimdhënësve për të përballuar situatat e reja e plot sfida.SBASHK-u ishte kthyer në shtyllë të fuqishme në mbrojtje të arsimit e kulturës sonë.

Arsimimi sot:

Në vitet 90-ta u punua me zell e sakrificë. A vlerësohen si e sa duhet ato vite dhe gjithë ai kontribut?

Bislimi:

Në ato vite organet e formuara të Republikës së Kosovës dhe populli vlerësuan lart punën e punëtorëve të arsimit. Populli me aq sa kishte filloi edhe ta përkrahte materialisht arsimin. Pas mbarimit të luftës kishte një zbehje të kujdesit ndaj arsimit të ne dhe ndaj gjithë atyre njerëzve që punuan pikërisht në vitet për të cilat fola. Arsye mund të jetë edhe qasja dhe vendimet e UNMIK-ut. Ata sollën reforma e reforma pa vullnetin tonë dhe i imponuan ato reforma që vinin nga shtetet e zhvilluara, por që nuk përshtateshin me kushtet momentale në Kosovë. Më vonë organet qeverisëse të Kosovës filluan me angazhimet në radhë të parë për përmirësimin e infrastrukturës e pastaj edhe me ngritjen e mirëqenies sociale për të punësuarit në arsim. Do theksuar se pas vitit 2008 Qeveria filloi dukshëm të kontribuojë në përmirësimin e gjendjes materiale për këtë i jemi mirënjohës.

Arsimimi sot:

Si e shihni SBASHK-un sot?

Bislimi:

SBASHK-u sot është partner serioz kudo në vendimmarrje për të gjitha çështjet në arsim. Kjo është arritur me punën e përkushtuar dhe me dëshmitë e vazhdueshme e në praktikë se mësimdhënësit dhe SBASHK-u në tërësi janë të përkushtuar në shërbim të arsimit dhe në shërbim për të punësuarit në këtë sferë të rëndësishme për Kosovën. SBASHK-u po angazhohet sinqerisht në realizimin e kërkesave të anëtarësisë dhe ka ndikuar e po ndikon edhe në reformimin e arsimit. Këtë e kanë kuptuar të gjithë dhe prandaj SBASHK-u po gëzon respekt nga të gjithë partnerët, por edhe nga opinionin dhe sindikatat simotra ndërkombëtare.

Arsimimi sot:

Gëzoni respekt të lartë nga të gjithë në SBASHK. Si e keni arritur këtë ?

Bislimi:

SBASHK-u fatmirësisht ka shumë Bislima, e ka thënë kryetari Rrahman Jasharaj teksa po ma festonin ditëlindjen kolegët sindikalistë. Unë duke iu falënderuar sjelljeve korrekte të kolegëve kudo në Kosovë kam krijuar një imazh se vetëm me sinqeritet, punë, tolerancë në mendime, besim e vetëbesim arrihen rezultate, por edhe jepet mundësi për zgjidhjen e të gjitha çështjeve. Unë ndjehem krenar sepse e shoh se dikur edhe sot e gjithmonë të gjithë në SBASHK me respektojnë. Unë gjithë jetën do të jem pjesë e SBASHK-ut dhe do të vazhdoj t'i këshilloj të rinjtë. Po e them edhe një herë se SBASHK-u ishte dhe mbeti mbrojtë e arsimit të Kosovës. SBASHK-u sot është pjesë aktive e sindikalizmit ballkanik, evropian e botëror sepse ka bashkëpunim të sinqertë e korrekt me shumicën e sindikatave nga e tërë bota. Arritjet po vazhdojnë dhe ato janë meritë e njerëzve që u angazhuan sinqerisht që nga themelimi i SBASHK-ut e deri me sot.

Arsimimi sot:

Porosia juaj për anëtarët e SBASHK-ut

Bislimi:

Të jesh anëtar i SBASHK-ut është privilegj. Aty mund të mësosh, të njohësh me botën e arsimit. SBASHK-u është i fuqishëm dhe me unitetin që ka po arrijnë të mbrojnë interesat dhe të realizojë kërkesat e anëtarësisë. SBASHK-u ka shënuar arritje të shumta dhe për këtë meriton përgëzime dhe respektin e të gjithëve. Dëshirë imja është që SBASHK-u të vazhdojë me demokratizimin e shoqërisë në tërësi. Si veteran i arsimit falënderoj gjithë anëtarët e SBASHK-ut që kanë punuar e po punojnë bashkërisht duke kontribuar në zhvillimin e vazhdueshëm të arsimit. Kam porosi për kolegët e rinj që të këshillohen me kolegët më të moshuar dhe të marrin ato përvojat e mira dhe t'i udhëheqim nxënësit tanë kudo në Kosovë në rrugë të mbarë e drejt dijes e shkencës. Kolegë të nderuar kudo jeni gëzuar 7 Marsin këtë festë të madhe të shkollës dhe arsimit shqip.

Gjatë muajit

SBASHK-u u takua me kabinetin qeveritar të Kosovës Gatishmëri e Qeverisë për zgjidhjen e kërkesave të SBASHK-ut

Në ambientet e Qeverisë së Kosovës kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj, kryesia dhe anëtarët e Këshillit Drejtues janë takuar me Kryeministrin e Kosovës, Isa Mustafën, Zv/kryeministrat Hashim Thaçi



e Kujtim Shalës dhe me Ministrat Arban Abrashi e Arsim Bajrami. Ishte ky një takim në përbërje të gjerë e në kuadër të vazhdimit të dialogut me institucionet e Kosovës për shumë çështje aktuale në Arsimin Parauniversitar dhe atë Universitar të Kosovës.



Kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj ka deklaruar se ishte kërkesë nga të gjitha komunat e Kosovës dhe kryetarëve të të tri niveleve arsimore për një takim në përbërje kaq të plotë. Ai pastaj ka falënderuar Kryeministrin Mustafën dhe kabinetin qeveritar për gatishmërinë e shprehur për dialog. Në vazhdim të fjalës së tij kryetari i SBASHK-ut kujtuar Qeverinë e Kosovës për kërkesat aktuale duke u ndalur pastaj në secilën kërkesë veç e veç. Kryetari Jasharaj ka kërkuar nga Kryeministri dhe kabineti i tij qeveritar që të shtojnë angazhimet dhe në bashkëbiseda me institucionet lokale të pushtetit të realizohen edhe kërkesat që i takojnë këtij niveli të pushtetit e që janë dhënia e tri pagave me rastin e pensionimit të të punësuarve në arsim dhe zgjidhja e

çështjes së udhëtimit për mësimdhënësit udhëtarë. Kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj ka kërkuar edhe një herë në këtë takim të përbërjes më të lartë që institucionet shtetërore të angazhohen për realizimin edhe të kërkesave të anëtarësisë së SBASHK-ut në Universitet duke përmendur edhe me këtë rast se është fjala për kërkesën e vazhdueshme për nënshkrimin e Kontratës Kolektive për Universitetin, për unifikimin e pagës bazë dhe pjesës stimuluese për të punësuarit në administratën e Universitetit dhe për kërkesa të tjera.

Kryeministri, Isa Mustafa është shprehur para përfaqësuesve të SBASHK-ut se Qeveria çmon punën e të punësuarve në arsim dhe se është e përkushtuar që brenda mundësive buxhetore të plotësojë kërkesat e arsyeshme të SBASHK-ut. Ai ka dhënë edhe një vlerësim të përgjithshëm të situatës në Kosovë dhe të përpjekjeve në shumë sfera.

Edhe Zv/Kryeministri Hashim Thaçi ka lavdëruar angazhimet e mësimdhënësve nëpër vite e dekada dhe është shprehur se Qeveria do të vazhdojë me dialogun me SBASHK-un ë përpjekje për të gjetur zgjidhje meritore për të gjitha çështjet.



Kryeministri Mustafa dhe Zv/Kryeministri Hashim Thaçi duke ju drejtuar pjesëmarrësve të këtij takimi kanë folur edhe për situatën aktuale duke theksuar se duhet zgjidhur çështjet me dialog e jo me dhunë e sulme ndaj institucioneve

Edhe Ministrat Bajrami e Abrashi kanë shprehur gatishmërinë e Ministrive, që drejtojnë për dialog me SBASHK-un për të gjitha çështjet në përpjekje që bashkërisht të gjejnë zgjidhje.

Edhe një takim me Ministrin Abrashi

Formular unik për tërë Kosovën lidhur me aplikimin për pensione



Pasi ishte arritur marrëveshje me 14 janar që të implementohet në praktikë e drejta e mësimitdhënësve që vitet 90-99 të numërohen si vite kontributdhënësve, një delegacion i SBASHK-ut i përbërë nga kryetari Rrahman Jasharaj dhe menaxheri financiar Ymer Ymeri janë takuar me Ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Arban Abrashi. Temë e bisedës në këtë takim të radhës ishte informimi për arritjen e marrëveshjes në mes të Ministrisë së Punës e Mirëqenies Sociale dhe MASHT-it për çështjen

teknike të implementimit të marrëveshjes së 14 janarit e që ka të bëjë me pensionet e plota kontributdhënësve për një pjesë të mësimitdhënësve, që këtë të drejtë nuk e kanë gëzuar nga prilli i vitit të kaluar e që ndërlidhej me vitet 90-99.

Ministri Abrashi ka informuar delegacionin e SBASHK-ut e sekretarët e përgjithshëm të Ministrisë që ai drejton dhe ai i MASHT-it janë takuar pikërisht për këtë çështje dhe kanë arritur marrëveshje që të përpilohet një formular unik për tërë Kosovën që kërkon shënime konkrete e të cilat do të plotësohen dhe vërtetohen në Drejtoritë Arsimore pasi që të pensionuarit të kenë sjellë në këto drejtori vërtetimin për vitet 90-99 nga shkollat në të cilat kanë punuar gjatë atyre viteve.

Ministri Abrashi dhe delegacioni i SBASHK-ut kanë biseduar edhe për çështje të tjera dhe janë pajtuar që përfaqësues të SBASHK-ut të jenë përfshirë në edhe më shumë në gjithë takimet e institucioneve dhe komisioneve kur debatohet dhe vendoset për ndryshime ligjesh dhe për përgatitjen e Ligjeve që janë të ndërlidhur me arsimin dhe të punësuarit në këtë sektor të rëndësishëm.

Marrëveshje të niveleve vendore e ndërkombëtare për zbritje çmimesh të shërbimeve Në bregdetin turk, atë shqiptar dhe me bizneset vendore

Respekti për të punësuarit në arsimin Kosovës dhe për punën e angazhimet që po bën SBASHK-u në shërbim të tyre ka bërë që të shtohet vazhdimisht numri i marrëveshjeve me bizneset, institucionet shëndetësore private dhe me institucione të pushimit e rekreacionit. Numri i marrëveshjeve ka kaluar numrin prej 120 sosh. Edhe në këtë numrin festiv të gazetës sonë ftojmë anëtarësinë tonë që të gëzojnë shërbimet për zbritje çmimesh edhe në bazë të 120 marrëveshjeve të arritura me bizneset, institucionet arsimore private dhe institucionet private shëndetësore e rekreative anë e kënd Kosovës, por edhe në Shqipëri e vende të tjera.

Në bregdetin turk



Pasi që viteve të kaluara ka pasur edhe punëtorë të arsimit që bashkë me familjet dhe me farefisin që punojnë e jetojnë jashtë Kosovës kanë vizituar edhe bregdetin turk të Antalisë, SBASHK-u për të

mundësuar qëndrimin e tyre me çmime më të lira ka arritur të nënshkruaj një marrëveshje me Kompaninë Turistike "Sierra Tourism", që përfaqësohet nga z. Ali Kocakaya, i cili ka bashkëpunim të shkëlqyer me shumë organizata të bizneseve në Kosovë e vende tjera të Ballkanit.

Marrëveshja është nënshkruar në atmosferë solemne në selinë e SBASHK-ut dhe ajo parasheh zbritje çmimesh prej 20 % për pakot e aranzhmanit turistik. Janë duke u punuar që të krijohet mundësia e realizimit të marrëveshjes përmes bankës në mënyrë që pushuesit të kenë mundësi që të paguajnë me këste mujore. Përfaqësuesi i Kompanisë "Sierra Tourism" ka falënderuar SBASHK-un për pritjen dhe pas nënshkrimit të marrëveshjes është shprehur se pushuesit atje do të jenë shumë të kënaqur me shërbimet dhe çmimet.

Kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj shprehet me rastin e nënshkrimit të marrëveshjes se kjo është bërë me qëllim që të punësohet në arsim, që janë anëtarë të SBASHK-ut, nëse vendosin të pushojnë në bregdetin turk atëherë të gëzojnë zbritje çmimesh prej 20 % për shërbimet atje.

Në Velipojë



Në vazhden e këtyre angazhimeve është lidhur edhe një marrëveshje me Hotelin "M. Selmani" në Velipojë, e cila saktëson se të gjithë anëtarët e SBASHK-ut që zgjedhin të pushojnë në bregdetin e bukur të Velipojës dhe në Hotelin "M. Selmani" do të gëzojnë zbritje të çmimeve prej 20 % për shërbimet atje.

Hotel "M. Selmani" ndodhet në Velipojë, pasi të kalohen rrugët numër një dhe dy, gjegjësisht prapa

Hotelit "Princi". Me pronarin e Hotelit mund të kontaktohet në tel. +355 67 374 7396 për të marrë informacione plotësuese. Pushuesit që zgjedhin këtë hotel për të pushuar kanë mundësi që të përdorin ambientet e hotelit vetëm për të fjetur e për të pushuar e ushqimin ta sigurojnë diku tjetër a ta përgatitin vetë, apo të shfrytëzojnë të gjitha shërbimet, pra fjetjen dhe ushqimin dhe për këtë merren vesh me pronarin e hotelit me rastin e akomodimit atje. Të gjithë anëtarëve tonë Ju dëshirojmë pushime të këndshme e me plot përshtypje të bukura në bregdetin shqiptar.

Në këtë numër të gazetës sonë po ju informojmë edhe për marrëveshjet me SHPK "ALEX" e pronarit Arben Kadriu, që ua mundëson anëtarëve të SBASHK-ut zbritjen prej 3 % të produkteve këtu. Një marrëveshje tjetër është ajo me Ordinancën "FOTO – DHËMBI" me pronar Avni Ratkoceri, që u siguron anëtarëve të SBASHK-ut zbritjen prej 11 % për fotografim të dhëmbëve. Marrëveshja me barnatoren NTP "MENTH" e pronarit Muhamet Lekaj siguron zbritje çmimesh prej 5 % për produktet mjekësore në këtë barnatore. Marrëveshja me NTP "KUSHTRIMI" në Magurë, e pronarit Sadik Kadriu, siguron zbritje çmimesh prej 5 % për të gjithë artikujt këtu.

Marrëveshja me SHPK "GIPA" e pronarit Ragip Avdyli siguron zbritje çmimesh prej 3 centë për çdo litër të derivateve dhe zbritje çmimesh prej 7 % për material ndërtimor po në ndërmarrjen "GIPA", SBASHK-u shpreh respekt për këta njerëz të vullnetit të mirë dhe fton anëtarët e vetë që të gëzojnë këto mundësi për zbritje çmimesh në SHPK "ALEX", Ordinancën "FOTO – DHËMBI", barnatoren NTP "MENTH", NTP "KUSHTRIMI" në Magurë dhe SHPK "GIPA" dhe falënderon edhe kryetarin e SAF e SAM të Lipjnit, Rrsutem Bublica dhe veprimtarët tjerë të sindikatës në Lipjan.

SBASHK-u vazhdon angazhimet për forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar SBASHK-u mysafir i sindikatës turke të arsimit “Eğitim-Bir-Sen”



Me ftesën e sindikatës më të madhe të arsimit Eğitim-Bir –Sen, që numëron 400.000 anëtarë delegacion i SBASHK-ut ka qëndruar për tri ditë në Turqi duke zhvilluar takime me mikpritësin dhe me shumë delegacione të sindikatave mysafire.

Delegacioni i SBASHK-ut, i kryesuar nga kryetari Rrahman Jasharaj, e në përbërjen e të cilit ishin edhe sekretarja e përgjithshme, znj. Jehona Oruqi dhe menaxheri i financave në SBASHK, Ymer Ymeri. ka zhvilluar disa takime me kryetarin e “Eğitim- Bir-Sen”, z. Ali Yalçın dhe me përfaqësues të tjerë të kësaj sindikate. Mikpritësi ka ka cituar mendimin e njeriut të madh me prejardhje shqiptare, Mehmet



Akif “Kur bëhet fjalë për njeriun, drejtimi i rrugës sonë duhet të jetë i njëjtë”. Kryetari Ali Yalçın pastaj

në një bashkëbisedë të lirshme ka përgëzuar SBASHK-un për angazhimet dhe arritjet e pastaj ka shpalosur historikun e sindikatës që ai drejton. Në mesin e mysafirëve të ftuar ka pasur delegacione nga Ballkani siç është SPASH nga Shqipëria, nga sindikata e Arsimit të Maqedonisë, Malit të zi, Kroacisë, Bosnje dhe Hercegovinës, Sanxhakut dhe kryetari i BSPK-së z.Haxhi Arifi.

Kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj duke u paraqitur me një fjalë përshëndetëse para 3000 pjesëmarrësve në aktivitetet e sindikatës më të madhe turke të arsimit dhe para delegacioneve të shteteve mysafire ka falënderuar mikpritësin për pritjen e pastaj ka folur për arritjet dhe sfidat e SBASHK-ut duke shprehur gatishmërinë për bashkëpunim të sinqertë me sindikatat simotra ndërkombëtare. Në vazhden e takimeve dhe aktivitetëve SBASHK-u me sindikatën më të madhe të arsimit turk kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi e cila precizon se të dy sindikatat do të shkëmbejnë përvoja përmes specialistëve sindikalë , por edhe do të organizojnë takime e konferenca të përbashkëta për të diskutuar problemet në sferën e arsimit në këto dy shtete , por edhe në vendet tjera të Ballkanit, Evropës dhe kudo në botë.



Në kuadër të këtij bashkëpunimi një delegacion i SBASHK-ut është ftuar në një Konferencë ndërkombëtare lidhur me njeriun e madh e me prejardhje shqiptare, Mehmet Akif.

Bashkëbisedë me lexuesit e gazetës sonë

Ta punojmë bashkë gazetën tonë

Të nderuar lexues kudo jeni Ju përshëndesim dhe ju dëshirojmë shumë suksese arritje dhe çdo të mirë në jetë. Gazeta elektronike “Arsimimi sot” është juaja. SBASHK-u përmes kësaj gazete ka për qëllim që të sjellë sa më afër jush lajmet kryesore lidhur me aktivitetet që zhvillon sindikata jonë. Redaksia e gazetës po bën gjithë përpjekjet që gazeta të jetë sa më përmbajtjesore dhe ka dëshirë shumë të madhe që ajo të jetë e pëlqyer nga ju. Për të qenë gazeta jonë edhe më përmbajtjesore dhe me tema të cilat ju zgjojnë kërshërinë ju lusim të na shkruani e të

propozoni se për çfarë dëshironi të lexoni në çdo numër të radhës. Presim që anëtarët e nderuar të SBASHK-ut, por edhe ju lexues të gazetës sonë kudo jeni të shkruani për aktivitete dhe arritjet që ndodhin në shkollën tuaj, në komunën tuaj. Shkrimin shoqërojeni me një a më shumë foto dhe ato do të botohen. Kështu gazeta do të ishte edhe më e plotë dhe më e pëlqyer nga lexuesit. Pra, ju ftojme për bashkëpunim dhe edhe një herë Gëzuar festën e madh të mësuesit dhe shkollës shqipe.

Në përpjekje për ta forcuar zërin sindikal në Kosovë

Kryesia e SBASHK-ut u takua me kryetarin e BSPK-së, z. Haxhi Arifi

SBASHK-u në vazhdimësi është duke u angazhuar për realizimin e kërkesave të anëtarësisë. Jo në pak raste kjo sindikatë ka bërë veprime e angazhime nga të cilat kanë përfituar edhe sindikatat tjera që kanë qëndruar në heshtje e duke mos bërë as edhe një angazhim konkret lidhur me çështjet e përbashkëta për të gjithë të punësuarit në Kosovë.



Me qëllim që të forcohet zëri sindikal në Kosovë dhe që, edhe nëse nuk ndihmojnë së paku mos të dalin me deklarime të pamatura sindikatat tjera, Kryesia e SBASHK-ut ka organizuar një takim me kryetarin e BSPK-së, z. Haxhi Arifi. Në këtë takim është thënë nga të dy palët se duhet shtuar bashkëpunimi dhe duhet koordinuar aktivitetet në shërbim të anëtarësisë. Kryetari i BSPK-së Haxhi Arifi ka folur për angazhimet që po bëhen në Këshillin Ekonomik Social për të zgjidhur çështjet në infrastrukturën ligjore lidhur

me të drejtat e të punësuarve në sektorin publik e atë privat.



Kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj dhe anëtarët e kryesisë janë deklaruar se po vazhdojnë me shumë aktivitete në shërbim të anëtarësisë dhe se janë shënuar edhe arritje. Ata kanë deklaruar se ende ka sfida që më lehtë tejkalohen nëse sindikatat do ta përkrahnin njëra-tjetrën. Ata kanë shtuar se kryesia e SBASHK-ut do të vazhdojë të jetë zë i anëtarësisë dhe se të punësuarit në arsim, që janë shembulli më i mirë i përkushtimit në punë dhe aktivitete sindikale. “Kërkesat e anëtarësisë janë obligim yni dhe ne do të veprojmë ashtu si kërkojnë anëtarët e SBASHK-ut nga ne dhe se jemi të interesuar për një bashkëpunim më të madh mes sindikatave në Kosovë sepse duke bashkëpunuar e ruajmë pavarësinë, por edhe e ndihmojmë zhvillimin dhe forcimin e sindikalizmit në Kosovë”, ka dalë si qëndrim nga ky takim.